



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR KOMANDIMIN E 1 (NJË) MAGJISTRATI
PROKUROR, SI KËSHILLTAR LIGJOR PRANË KLP**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë në përputhje me nenin 53 pikat 1 dhe 2 dhe 54, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 176 pika 3 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, fton të gjithë prokurorët të cilët nuk shërbejnë në një pozicion me mandat të kufizuar dhe që nuk janë të komanduar në ndonjë pozicion tjetër, të shprehin interesin për t’u komanduar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë konkretisht për **1 pozicion si Këshilltar Ligjor për një afat 3 (tre) vjeçar.**

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikimin brenda datës **12.11.2024, ora 24.00** pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ose në adresën e e-mail karriera@klp.al;

Kriteret e kërkuara për këtë pozicion janë si më poshtë :

- të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- të ketë ushtruar profesionin e magjistratit për të paktën 5 vite;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Sekretarin e Përgjithshëm ose prokurorët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Do të ketë përparësi kandidati që plotëson këto kriteret:

- ka vjetërsinë më të madhe në ushtrimin e funksionit të prokurorit;
- ka ekspertizë në fushën e hartimit të akteve rregullatore;
- është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës;
- ka njohuri në një nga këto gjuhë: anglisht, gjermanisht, frengjisht, spanjisht, italisht;
- ka aftësi shumë të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale;
- ka trajnime dhe angazhime të tjera profesionale;
- për vërtetimin e këtyre kriterëve, kandidati mund të paraqesë: rekomandim/referenca apo kontakte që ai çmon të nevojshme.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mund të marrë në intervistë kandidatët.

Kërkesa për shprehjen e interesit duhet të përmbajë këto dokumente:

1. Letër motivimi ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy faqe A4).
2. CV- në e përditësuar të kandidatit.
3. Deklaratën për papajtueshmërinë ambjentale.
4. Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm në funksion të këtij kandidimi.

Mirëpresim aplikimet Tuaja!